




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.379/2023

Datë: 28 korrik 2023

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 dhe nenit 40, paragrafi 1 i Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, vendimit KGJK.nr.187/2023 i datës 18 maj 2023, në mbledhjen 313-të, të mbajtur më 28 korrik 2023, merr këtë:

### V E N D I M

- I. Z. Jeton Krasniqi, gjyqtar në Gjykatën Themelore Prishtinë - Dega në Lipjan, propozohet mentor për trajnimin praktik nga lëmia civile, për gjyqtarin Astrit Gashi, me mandat fillestar në Gjykatën Themelore Prishtinë – Dega në Gllogoc.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 28 korrik 2023.

### A r s y e t i m

Me vendimin KGJK.nr.45/2023 të datës 09 shkurt 2023, z. Astrit Gashi është propozuar që të emërohet gjyqtar me mandat fillestar në Gjykatën Themelore ne Prishtine - Dega ne Gllogoc. I njëjti është dekretuar te Presidentja e Republikës së Kosovës me datë 7 prill 2023, gjyqtar i Republikës së Kosovës.

Gjyqtari z.Gashi, më herët ka ushtruar profesionin prokuror i Republikës së Kosovës dhe e ka të përfunduar programin fillestar për prokuror në fushën penale.

Duke qenë se i njëjti, e ka të përfunduar programin fillestar si prokuror në lëminë penale, si kusht për ushtrimin e profesionit, KGJK-ja me vendimin Nr.187/2023 të datës 18.05.2023 ka vendosur që z. Gashi të ndjek trajnimin fillestar vetëm sa i përket lëmisë civile.

Duke marr parasysh se z. Gashi ka përfunduar trajnimin teorik në lëminë civile dhe të njëjtit duhet t'i caktohet mentori lidhur me mbajtjen e trajnimit sa i përket pjesës praktike, me qëllim të zbatimit të vendimit të KGJK-së, Nr. 187/2023 të datës 18.05.2023, u vendosi si ne dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Akademisë së Drejtësisë;
- Kryetares së Gjykatës Themelore Prishtinë;
- Sekretariatit të KGJK-së,
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në SKGJK, si dhe
- Arkivit.